



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 11/77  
Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



*Republika e Kosovës*  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*  
*Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare*

---

## KONCEPT DOKUMENT

**për trajtimin dhe kategorizimin e personave me aftësi të kufizuara**

### Kapitulli - I

#### 1. Hyrje - (Dokumentet ndërlidhëse)

Çdo person gëzon të drejtat universale të cilat janë të përcaktuara me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, ndërsa të drejtat e garantuara për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, përcaktohen me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e natyrshme dhe integrale e shoqërisë si tërësi, të cilëve shteti duhet t'i ofrojë garanci dhe mundësi që përmes formave të ndryshme, PAK-ja të mund të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë dhe në të njëjtën kohë të integrohen në proceset e ndryshme shoqërore, për përfshirjen dhe trajtimin e duhur të kësaj kategorie pa asnjë lloj diskriminimi.

Korniza ligjore e cila merret me rregullimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si në kuptimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, e po ashtu edhe të drejtës ndërkombëtare, është mjaftë e gjerë.

Parimi i mundësive të barabarta në punësim dhe politika sociale, përbën një të drejtë universale e njohur nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara, e miratuar në vitin 2006.



Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Në veçanti, neni 28 i Konventës prezanton standardet e duhura të jetesës dhe mbrojtjes sociale, si dhe përcakton qartë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në programet dhe përfitimet e pensionit apo kompensimit. Me nënshkrimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD), BE-ja, ka miratuar Strategjinë Evropiane për Personat me Aftësi të Kufizuara 2010-2020. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të mund t'i gëzojnë të drejtat e tyre të plota dhe të përfitojnë plotësisht nga pjesëmarrja në shoqëri dhe në ekonominë evropiane.

Burimet kryesore ndërkombëtare dhe evropiane për të drejta e personave me aftësi të kufizuara në masë të konsiderueshme, janë inkorporuar në sistemin tonë juridik dhe janë të rregulluara me Kushtetutë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në kapitullin e II-të "Të drejtat dhe liritë themelore", promovon parimin se: "Te drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës".

Republika e Kosovës, duke respektuar parimet ndërkombëtare, përveç që ka garantuar juridikisht të drejtat dhe liritë e qytetarëve, ka hartuar edhe politika të zhvillimit, të ndërtimit dhe avancimit të mirëqenies për të gjithë qytetarët e vet, duke respektuar normat dhe parimet juridike.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013 -2023, si dhe Planin e Veprimit të zbatimit të kësaj strategjie.

Qëllimi i kësaj strategjie është që të promovojë, mbrojë dhe sigurojë zbatimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara, si dhe të kontribuojë në respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm.

Njëra prej objektivave të kësaj strategjie është mbrojtja sociale, që duhet të mbështesë të gjithë personat në nevojë, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Kjo e drejtë dhe nevojë do të jetë sigurisht më e theksuar tek femrat dhe të moshuarit me aftësi të kufizuara, si kategori e cila konsiderohet më e rrezikuar në shoqëri. Instrument tjetër i rëndësishëm në aspektin e rregullimit ligjor të çështjes së përfitimit të pensioneve të financuara nga shteti për personat me aftësi të kufizuara është Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili përfshin Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit



Kontributpagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizua, Skemën e Pensionit të Parakohshëm, si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale.

Po ashtu, është nxjerrë edhe Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ky Ligj ka për qëllim përkrahjen ligjore dhe institucionale për aftësim, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara, duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta.

Qeveria e Kosovës, përkatësisht, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka hartuar Strategjinë Sektoriale 2015-2020 dhe Planin e Veprimit 2015-2020.

Objektiv i kësaj strategjie është rritja e nivelit të punësimit dhe ngritja e aftësimeve profesionale sipas kërkesës së tregut të punës. Një ndër qëllimet e saj është edhe hartimi i masave dhe politikave zhvillimore për grupet e cenueshme, me theks të veçantë, punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, është miratuar edhe Ligji nr. 04/1-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, sipas këtij ligji Agjencia e Punësimit e Kosovës është ofrues publik i shërbimeve në tregun e punës, që ka për qëllim administrimin e tregut të punës dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësimin profesional.

Çështja e aftësisë së kufizuar është e rregulluar edhe me Ligjin e veçantë që rregullon të drejtat themelore të personave të verbër, Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër.

Ky ligj ka për qëllim rregullimin e statusit ligjor të personave të verbër në Republikën e Kosovës, të drejtat dhe përfitimet, si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbër.

Gjithashtu është miratuar edhe Ligji nr. 05/1 -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme, apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme. Ky ligj rregullon edhe kompensim mujor për këta persona.



Krahas këtyre iniciativa legislative me qëllim të avancimi të kornizës ligjore, MPMS-ja, në kuadër të Strategjisë Sektoriale 2018-2020 ka paraparë si aktivitete të saj edhe hartimin e Projektligjit për Trajtimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky ligj do të garantojë trajtimin e barabartë të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara, në pajtim me normat dhe praktikat ndërkombëtare, ku si qëllim i tij është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të tyre në përfitime financiare dhe beneficione të tjera.

## **Kapitulli -II-**

### **2. Përshkrimi i çështjes / Problemit kryesor**

E drejta në pension të plotë dhe disa përfitimeve tjera të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, deri më dt. 01.01.2015, është trajtuar me **Ligjin Nr. 2003/23, për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë**, ndërsa nga viti 2015, kjo e drejtë është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, sipas nenit 9 janë paraparë kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme.

Sipas këtij ligji, një person do të konsiderohet se është me aftësi të kufizuara nëse është në mes të moshës 18 – 65 vjeç dhe ka diagnozë mjekësore të gjendjes fizike, ndijore ose mendore, ka sëmundje ose aftësi të kufizuar që e bëjnë atë të paaftë për çfarëdo pune shpërblyese. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas këtij ligjit, gëzojnë të drejtën e pensionit të plotë sipas paaftësisë së tyre, në shumën prej **75 eurosh**. Personat me aftësi të kufizuara të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension të plotë, sipas këtij Ligji, nuk kanë të drejtë edhe të asistencës personale apo kujdestarit dhe përfitime tjera të domosdoshme, të cilat PAK-ve i mundësojnë integrimin e tyre në shoqëri. Sipas këtij ligji nuk janë të kategorizuar personat me aftësi të kufizuar sipas shkallës së invaliditetit apo aftësisë së mbetur për punë. E drejta në pension të plotë për shkak të paaftësisë së përhershme, sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ka mundësuar që një numër i madh i PAK-ve, të kategorive të ndryshme, të mos përfitojnë pension nga kjo skemë.

Duke ditur se Kosova me legjislacion, ende nuk i ka të rregulluara përfitimet financiare dhe beneficionet për personat me aftësi të kufizuara, varësisht prej shkallës së invaliditetit dhe aftësisë së mbetur për punë, është krijuar shumë vështirësi në jetën e përditshme të tyre, si dhe në integrimin e plotë në shoqëri. Mungesa e kësaj të drejte te PAK-ja, ka hapur rrugët e pakënaqësive të përfaqësuesve të tyre që të iniciojnë hartimin ligjeve të veçanta, të cilat i rregullojnë të drejtat e tyre në përfitime financiare dhe beneficione. Ligji i parë i



veçantë i cili ka rregulluar vetëm të drejtat në përfitime financiare dhe beneficione, është Ligji 04/L-092 për të Drejtat e Personave të Verbër, i cili ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2012, ndërsa ka filluar së zbatuari nga 01.01.2013, sponsorues i të cilit ka qenë Zyra për Qeverisje të Mirë në Kuadër të ZKM-së.

Meqenëse MPMS-ja, sipas dispozitave të këtij Ligji është organi më kompetent për zbatimin e tij, në kuadër të obligimeve të dala, Ministri i MPMS-së për zbatimin e drejtë të këtij akti ligjor ka miratuar Rregulloren nr. 02/2013 për Funksionimin e Komisionit Mediko-Social (sipas nenit 17, paragrafi 2 të Ligjit).

Sipas këtij ligji, personat të cilët i plotësojnë kriteret, kanë të drejtë në kompensim financiar prej së paku 100 euro në muaj. Me këtij ligj është përcaktuar që kjo kategori, të këtë edhe kujdestarin personal i cili po ashtu përfiton me kompensim prej së paku 100 eurosh. Duke pasur parasysh se emërtimi i ligjit të lartpërmendur, ka të bëjë vetëm me personat e verbër, këtu kemi të bëjmë për kompensim financiare për personat e verbër. Sipas këtij ligji nuk përmendet fjala 'pension' dhe lidhshmëria mes kompensimit financiar për verbëri dhe fjalës 'pension', që do duhej të ndahet nga kompensimi financiar, duke paraparë kriteret se kur gëzon pension dhe kur do të gëzojë beneficion. Në kuadër të kësaj, problem kryesor ka dal se me rastin e zbatimi të këtij ligji, çdo person i verbër, me rastin e kualifikim sipas këtij ligji, nuk mund t'i gëzojë të drejtat e tjera të fituara në baza ligjore, që është një kundërshtim ndërmjet paragrafi 1 dhe 3 të nenit 7 të ligjit.

Nga elaborimi i çështjes kryesore dhe problemeve që janë shfaqur, ky ligj është konsideruar si nxitës i shumë pakënaqësive të OJQ-ve tjera, të cilat përfaqësojnë interesat e PAK-ve. Problemi kryesor konsiderohet se ky ligj me të drejta të cilat i ka paraparë, ka krijuar epërsi apo diskriminim ndaj llojeve tjera të aftësisë së kufizuar.

Po ashtu, e njëjta çështje do të ndikonte edhe për skemat e TMK-së, FSK-së, Pensionet e Parakohshme të "Trepçës" dhe Skemën e Invalidëve të Luftës, kur shkak i përfitimit të pensionit është fituar në bazë të verbërisë.

Duke parë këtë trend të zhvillimit të avancimit të një kategorie krahas kategorive tjera të PAK-ve, me kërkesat dhe shtytjen e procesit nga Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, është hartuar dhe miratuar edhe Ligji nr. 05/1 -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme, apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme



mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor.

Përveç të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme, një pjesë e personave me aftësi të kufizuara, përfitojnë edhe nga legjislacioni që rregullon fushën e mbështetjes së familjeve të varfra, të cilët kanë brenda familjes persona me një shkallë të paaftësisë. Ligji Nr. 2003/15 për Skemat e Ndhmës Sociale, ka përcaktuar përveç kritereve tjera edhe të drejtën në ndihmë sociale për të gjithë PAK-të, të cilët e kanë mbi 80% të shkallën e aftësisë së mbetur për punë. Kjo kategori, sipas këtij ligji dhe amandamentimit të tij, përcakton një shumë të përfitimit, shumë e cila nuk është e njëjtë me pensionin e plotë të përcaktuar në Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Duke ditur se qëllimi i Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale është mbrojtja nga shteti vetëm për familje të cilat nuk kanë kurrfarë të ardhurash apo burim ekzistence, si dhe duke pasur parasysh pagesat e ndryshme jo të harmonizuara të llojeve të përfitimeve financiare të PAK-ve nga zbatuesit e këtij ligji, janë paraqitur kërkesa që personat me aftësi të kufizuara si përfitues të mos trajtohen si pjesë e Kategorisë së I të Ligjit të Skemës së Asistencës Sociale.

Problem tjetër në kuptimin e trajtimit të barabartë të të gjithë PAK-ve, është shënuar në Ligjin Nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme. Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme, prej moshës 1–18 vjet. Sipas këtij Ligji, të gjithë fëmijët e moshës 1 deri 18 vjet, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara, gëzojnë të drejtën e përfitimit financiar prej 100 eurosh në muaj. Këto pagesa ndërpriten, me rastin e njohjes së të drejtës në pension të plotë të paaftësisë së përhershme i përcaktuar sipas Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ky mosharmonizim, është evidentuar në pagesat e këtyre kategorive me rastin e kalimit nga skema e përkrahjes së fëmijëve 1-18 vjeç, në skemën e pensioneve të aftësisë së kufizuar 18-64 vjeç.

Gjithashtu, legjislacion në fuqi nuk përkrah fëmijët nga mosha 0-1 vjeç, në kuadër të këtij legjislacioni nuk garantohet asnjë shërbim psiko-social për fëmijët me aftësi të kufizuara, nuk njihet statusi i kujdestari personal për fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe nuk parashihen lehtësira për prindërit që kanë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Sipas gjendjes aktuale që kemi sot, legjislacioni i tashëm që ka të bëjë me pensionet invalidore, shërbimet dhe përfitimet e tjera financiare në njërën anë, dhe aftësia për punë, riaftësimi dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara në anën tjetër, përmban kundërshtime të caktuara. Përveç kësaj, fushëveprimi i këtij legjislacioni nuk i mbulon të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar, të personave



që mund të kenë nevojë për shërbime dhe përfitime tjera, prandaj ka shumë pakënaqësi nga këto komuniteteve, si: të Shurdhrit, Sindrom Down, Autizmi, personat shtatshkurtër dhe personat me aftësi të kufizuara të tjera.

Pakënaqësi dhe shqetësime të shumta në adresë të MPMS-së janë shprehura nga OJQ-të që përfaqësojnë interesa e PAK-ve, për një diskriminim i cili po bëhet ndaj tyre, e të cilët nuk përfitojnë as pension të plotë dhe as një lloj kompensimi tjetër financiar nga legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, pakënaqësi ka pas edhe me skemën e pensioneve të paaftësisë së përhershme, për procedurat e riaplikimit për një, tre dhe pesë vite. Kjo çështje është ngritur në debate të shumta në lidhje me shkallën apo "Përherëshmëria" e aftësisë së kufizuar dhe aftësinë për të vazhduar me përfitimin e të ardhura, dhe domosdoshmërinë e rivlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Problem i diskriminimit të kategorive të tilla, si: të shurdhët, sindrom down, autizmit, personat shtatshkurtër dhe personat me aftësi të kufizuara të tjera, ka qenë debat edhe në komisione parlamentare funksionale të Kuvendi të Republikës së Kosovës, si dhe me pranimin e shumë rekomandime nga ana e Avokatit të Popullit, ku është kërkuar trajtim i barabartë për të gjithë llojet e aftësisë së kufizuar në Kosovë.

Çështje tjetër për të cilat janë identifikuar probleme dhe pengesa, është edhe mos zbatimi në mënyrë të plotë i Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. PAK-të, të cilët nuk janë përfitues të pensionit të plotë të caktuar sipas Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, kanë të drejtën e punësimit dhe aftësimin profesional. Mungesa e njohjes së statusit të PAK-ve sipas shkallës së aftësisë së mbetur për punë nga Komisioni Mjekësor i MPMS-së, ka rezultuar negativisht në punësimin dhe aftësimin profesional të PAK-ve në tregun e punës. Mungesa e kategorizimit të PAK-ve sipas shkallës së aftësisë së mbetur për punë (për moshën madhore), si dhe përcaktimi i të drejtave të tyre varësisht prej kësaj shkalle, po ashtu, ka shfaqur shumë pakënaqësi dhe reagime të shumta nga përfaqësuesit e OJQ-ve të cilët i mbrojnë interesat tyre. Me kategorizimin e PAK-ve sipas shkallës së aftësisë së mbetur për punë dhe për të jetuar, do të krijoheshin edhe mundësitë e zbatimit më të mirë në praktikë të Ligjit për Punësim dhe Aftësim Profesional të PAK-ve.

Nismat e reja ligjore për hartimin e ligjeve të veçanta për secilën kategori të aftësisë së kufizuar, në rendin juridik, do të krijonte standardet të dyfishta që do të rezultonin me diskriminimin në mes të kategorive të PAK-ve, përkatësisht, do të krijonte pakënaqësi në çështjet e kompensimit financiar mbi nivelin e pensioneve të paaftësisë së përhershme dhe invalide.



Prandaj, MPMS-ja duke parë zhvillimin e këtyre iniciativave individuale nga grupet e veçanta të PAK-ve; duke u bazuar në praktikat me të mirat të vendeve të BE; si dhe me propozimin që avancimi i të drejtave për PAK-të të mos bëhen me ligje të fragmentuara, por që të gjithë llojet e aftësi së kufizuar të trajtohen brenda një ligji ombrellme (të drejta për shërbime dhe përfitime sipas kategorizimit), ka propozuar hartimin e Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

### 3. Politikat aktuale

Personat me aftësi të kufizuara në aspektin e beneficioneve financiare, nga janari i vitit 2004 trajtohen me Ligjin nr. 2003/23 (nëntor 2003) i emërtuar "Pensione të Personave me Aftësi të Kufizuara", i cili përfshin personat me aftësi të kufizuara nga mosha 18 deri 64 vjeç, si dhe Ligji nr. 03/L-022 për Përkrahjen e Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara nga 1-18 Vjeç (nga viti 2008).

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë / Nr. 35 / 05 Qershor 2014), i cili shfuqizon Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara (Rregullorja Nr. 2003/40 e UNMIK-ut). Me dispozitat e nenit 9 të Ligjit 04/L-131, rregullohen kriteret për përfitimin e pensioneve të personave me aftësi të kufizuara, që në esencë nuk i ndryshon kriteret e parapara me Ligjin nr. 2003/23.

Një person do të konsiderohet me paaftësi të përhershme, nëse: Ofron dëshmi se është me paaftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston paaftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo (5) vitesh.

Pas skadimit të afateve të përcaktuara me ligj, personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.

Referuar bazës ligjore aktuale, personat me aftësi të kufizuara, janë përfshirë në:

1. Skemën e Pensioneve të Personave me Aftësi të Kufizuara (PPAK),
2. Skemën e Përkrahjes së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara,
3. Pensionet Invalidore të Punës,
4. Kompensimin e Personave të Verbër,
5. Prej janarit 2017 ka filluar edhe Skema e Kompensimi të Personave Tetraplegjik dhe Paraplegjik.

Mënyra e deritanishme e zgjedhjes për grupet e personave me aftësi të kufizuara ka krijuar pakënaqësi dhe dallime në mes të llojeve të aftësisë së kufizuar. Kjo zgjidhje e pjesshme nuk ka arritur të përmbushë të drejtat universale për gjithë personat me aftësi të kufizuara, mbështetur mbi të drejtat e garantuara nga



Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, si dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Zgjidhja parciale do të krijojë pakënaqësi, diferenca dhe privilegje në mes të llojeve të aftësisë së kufizuar dhe jo vetëm që do të kemi një kosto buxhetore shumë më të lartë, por nuk do të arrijmë edhe përmbushjen e të drejtave universale për persona me aftësi të kufizuara, të bazuara në aktet juridike të përmendura më lart.

Duke u nisur nga nevoja për unifikimin e legjislacionit për të drejtat e personave me aftësitë kufizuara, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mbështetur në bashkëpunimin e saj me Forumin Kosovar për Aftësi të Kufizuar, organizatat ndërkombëtare, si dhe përvojat e shteteve tjera, propozon Ligjin i cili garanton mbrojtje sociale për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar.

Përmes kësaj politike synohet të arrihet:

- Ngritja e mirëqenies sociale për të gjitha personat me aftësi të kufizuara;
- Gjithëpërfshirja e llojeve të aftësisë së kufizuar;
- Kategorizimi në tri grupe, bazuar në përqindjen e aftësisë së kufizuar.

## **1. Ligjet dhe aktet nënligjore**

Korniza ligjore e Kosovës, e cila trajton çështjet e personave me aftësi të kufizuara, është shumë e gjerë dhe e shpërndarë në shumë fusha apo ligje të ndryshme. Varësisht prej qëllimit të ligjeve dhe mekanizmave zbatues apo institucioneve përkatëse, këto ligje rregullojnë edhe të drejta e personave me aftësi të kufizuara. Korniza aktuale ligjore e cila mbulon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është po ashtu multidisiplinare, që nënkupton se në garantimin dhe zbatimin e të drejtave të PAK-ve, janë të përfshirë shumë mekanizma apo institucione. MPMS-ja si institucion kryesor në hartimin politikave sociale që nga fillimi i mandatimit të saj deri me tani, ka hartuar dhe nxjerrë një mori aktesh ligjore dhe nënligjore nga fusha e të drejtave të PAK-ve. Ligji bazë apo e drejta në pension të paaftësi së përhershme dhe në pension invalidor të punës, siç kemi cekur edhe më lart, është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Qëllimi i këtij ligji është harmonizimi i të gjitha skemave pensionale të financuara nga shtetit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës. Me këtë Ligj, PAK-të e moshës 18 deri 65 vjeç, të cilët janë plotësisht të paaftë për punë, kanë të drejtë në pension të paaftësi së përhershme. Paaftësia e përhershme sipas ligjit, nënkuptohet kur një person apo individ, vlerësohet nga Komisioni Mjekësor, se është totalisht i paaftë për punë. Ky Ligj, siç e kemi shpjeguar më lartë, nuk e ka rregulluar çështjen e aftësinë së mbetur për punë apo shkallën e invaliditetit të PAK-së, e cila siç njihet ndryshe në literaturën e Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH), si e drejta e PAK-së në pension të pjesshëm, varësisht prej shkallës së aftësisë së mbetur për



punë. Përveç këtij ligji, MPMS-ja, është duke zbatuar edhe Ligjin nr. 03/1-022 për Përkrahjen Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme. Me këtë Ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme prej 1 deri 18 vjeç, dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahjeje materiale. Dallimet kryesore të trajtimit të çështjes së PAK-ve në këto dy ligje janë: diferenca e pagesës, mospërfshirja e moshës së fëmijëve nga 0-1 vjet, si dhe mospërfshirja e të gjithave llojeve të aftësisë së kufizuar. Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë një kompensim për efekt të aftësisë të kufizuar, duke përjashtuar përfitimin për efekt të varfërisë.

MPMS-ja, gjatë mandatit të saj ka hartuar edhe Ligjin Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky Ligj rregullon kornizën e përgjithshme të punësimit të PAK-së.

Ligji garanton të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara, me qëllim të integritetit të tyre në tregun e hapur të punës. Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij ligjit, MPMS-ja ka nxjerr tri (3) akte nënligjore:

- Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2010 për procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtave në aftësim, riaftësim dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2010 për përcaktimin e vendeve të punës dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2012 për mënyrën dhe rregullat e mbajtjes së evidencës për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, me Ligjin Nr. 05/1 -078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, përveç të tjerash me këtë Ligj bëhet edhe vlerësimi i aftësisë së mbetur për punën nga ana e komisioni Mjekësor Mediko-Social. Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij ligjit, MPMS-ja ka nxjerrë tri (3) akte nënligjore:

- Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 03/2018 për mënyrën, procedurat dhe afatet e pagesës mujore për punëdhënësit të cilët nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara;
- Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 04/2018 për fushëveprimin, kompetencat, përbërjen dhe mandatin e Komisionit Mediko-Social për vlerësimin e aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara;
- Udhëzimin Administrativ për mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara.



Po ashtu, ka finalizuar edhe draftin e Rregullores për lehtësirat doganore dhe tatimore për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara dhe për personat me aftësi të kufizuara që ushtrojnë veprimtari të pavarur, akt i cili së shpejti do të procedohet për shqyrtim dhe aprovim në Qeveri.

Ndalimi i diskriminimi në punësim, në përgjithësi për personat me aftësi të kufizuara, është e rregulluar në Ligjin Nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, i cili ka për qëllim, parandalimin dhe luftimin e diskriminimit dhe realizimin e parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit. Në veçanti, përcakton përfaqësimin e drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet.

**Ligji Nr. 03/L-212 i Punës**, përmban dispozita për mbrojtjen e PAK-së në punë, konkretisht neni 44 i tij, po ashtu, me këtë ligj është i ndaluar diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit. Ligji iu garanton të punësuarve të cilët paraqitet pa aftësia për punë, të drejtën të punojnë në punët përkatëse, komfor aftësive të tyre të mbetura për punë.

Ligji rregullon edhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit të tyre. Ligji Nr. 04/L-84 për Regjistrimin dhe Evidencën e të Papunësuarve dhe Punëkërkesve, është një ligj me rëndësi, sepse ka rregulluar bazën ligjore të funksionimit të regjistrimit dhe mbajtjes së evidencave në përgjithësi për të papunësit dhe ata të cilët kërkojnë punë aktivisht.

Sipas Ligjit Nr. 04/092 për Personat e Verbër, përveç se përcakton statusin ligjor të personave të verbër, ata realizojnë edhe të drejta të tjera, si: të drejtën në kompozim material; të drejtën në edukim dhe arsim; të drejtën në aftësim dhe riaftësim profesional; të drejtën në punësim; të drejtën në kujdes shëndetësor; të drejtën në lirim nga taksat, etj.

Për zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, është nxjerrë Rregullorja Nr. 02/2013 për Komisionin Mediko-Social, e cila ka për qëllim themelimin dhe funksionimin e këtij komisioni, si dhe përcaktimin e shkallës së verbërisë të personave të verbër.

Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familje të Tyre, zbatohet që nga viti 2012. Ky Ligj mbulon pothuajse të gjitha kategoritë e ndryshme që si rezultat i luftës kanë nevojë për mbështetje nga shteti. Në kuadër të këtij Ligji ekzistojnë 10 skema të ndryshme të pensioneve duke përfshirë kujdestarët për disa kategori. Problemi me këtë Ligj mbete kategorizimi i invalidëve të UÇK-së për dallim me invalidët civil, si në aspektin e kriterëve ashtu edhe të shumës financiare që marrin në muaj.



Përveç ligjeve të cekura më lartë, të cilat janë hartuar nga MPMS-ja, legjislacioni ynë përmban edhe dispozita relevante lidhur me personat me aftësi të kufizuara. **Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.** Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i edukimit, arsimit dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve, në veçanti të fëmijëve me nevoja të veçanta. Nenet 39-43 përcaktojnë të drejtën e institucioneve arsimore dhe në veçanti, kompetencat e komunave për përkujdesje ndaj fëmijëve të cilët janë me nevoja të veçanta. Sipas nenit 43 të këtij Ligji, komunat duhet të themelojnë ekip profesional vlerësues të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit për të vlerësuar aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës, për të përkufizuar nevojat për pajisje të posaçme që nevojiten në mësimdhënie, etj.

Ligji për Shëndetin Mendor, ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Neni 2 i këtij ligj përcakton procedurat, kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedisit social të përshtatshëm për personat me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Me këtë ligj përcaktohen procedurat, kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedisit social të përshtatshëm për personat me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

### **Punësimi dhe aftësimi profesional**

Numri i të regjistruarve në Zyrat e Punësimit si të Papunë është **443 PAK**, ku prej tyre femra janë **147** persona ndërsa meshkuj janë **286**;

#### **Ndërmjetësimi në punësim:**

*Ndërmjetësimi në punësimin e rregullt* për këtë kategori për periudhën 2017 deri T1 2018, është bërë për **9** punëkërkues, ku femra ishte 1 person dhe meshkuj **8** persona.

*Ndërmjetësimi në Masat Aktive të Tregut të Punës* për periudhën 2017 deri T1 2018, është bërë për **16** punëkërkues, ku femra kanë qenë **4** dhe meshkuj **12** punëkërkues.

**Referime në aftësimet profesionale:** Gjatë periudhës 2017 deri prill 2018, janë përfshirë në aftësim profesional **57** persona me aftësi të kufizuara.

Përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të MPMS/ APRK-së dhe Shoqatës "Down Syndrome Kosova", rreth implementimit të projektit "Fuqizimi i të rinjve me Sindromën Down", duke ju referuar fushës së aftësimin profesional kanë përfituar rreth 30 persona me aftësi të kufizuara.



Me hyrjen në fuqi të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, çështjet kryesore të cilat janë adresuar me procesin e plotësimit dhe ndryshimit të këtij Ligji, janë:

- Krijimi i mundësive më të mira për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në harmoni me ofertën dhe kërkesën në tregun e punës;
- Ndryshimi i kuotës prej 1% të pagës minimale të ligjit në fuqi, në 1 pagë minimale për çdo muaj. Kjo iu dedikohet punëdhënësve të cilët, nuk punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë;
- Hapja e një xhirollogarie të veçantë në buxhetin qeveritar, të dedikuar ekskluzivisht për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku punëdhënësit do të paguanin shumën/kontributin, në rastin kur nuk përmbushin obligimin ligjor për punësimin e PAK-së;
- Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë dhe mundësitë për punësim apo mbajtjen (ruajtjen) e punës, përfshin kriteret mjekësore, sociale dhe kritere të tjera të cilët përcaktojnë mundësitë dhe aftësinë e personave me aftësi të kufizuara për inkuadrimin e domosdoshëm në tregun e punës dhe kryerjen e punëve në mënyrë të pavarur apo me mjetet ndihmuese teknike, përkatësisht, punësimin në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta. Pra, për mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara MPMS-ja nxjerrë akt nënligjor;
- Ngritja e vetëdijes së personave me aftësi të kufizuara dhe opinionit në përgjithësi, përkitazi me mundësitë dhe potencialet për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

## **6. Vlerësimi plotësues i politikës aktuale**

Garantimi i të drejtës në shërbime dhe përfitime për personat me aftësi të kufizuara, do të përmirësonte më shumë gjendjen socio-materiale por edhe shpirtërore të PAK-së. Duke miratuar ligjin e ri, ku do t'iu sigurohen të drejtat pa diskriminim.

MPMS-ja ka hartuar dhe është miratuar Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Me zbatimin e këtij Ligji plotësohen disa zbraçetira të cila kanë qenë pengesë për punësimin dhe aftësimin e PAK-ve. Po ashtu, me miratimin e Ligjit Nr. 05/1 -077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuarit dhe Punëdhënësit, do të rregullohen kushtet dhe procedurat e regjistrimit të të papunësuarve, punëkërkuarve dhe



punëdhënësve, ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësim nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

MPMS-ja, gjithashtu ka hartuar edhe Ligjin për Ndërmarrjet Sociale, i cili është miratuar në Kuvend gjatë këtij viti. Aktivitetet e ndërmarrjeve sociale do të shërbejnë për interesat e përgjithshme shoqërore, në formë të sigurimit të mallrave dhe shërbimeve sociale që e rrisin cilësinë e jetës, e forcojnë bashkëpunimin shoqëror dhe e inkurajojnë integrimin e grupeve të cënueshme.

Zbatimi i Ligjit për Sigurimet Shëndetësore ka si qëllim sigurimin e qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor. Me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor. Personat me aftësi të kufizuara sipas këtij Ligji, janë kategoritë e liruara nga pagesa e premiumit, bashkëpagesat dhe detyrimet e tjera të bashkëfinancimit vetëm nëse identifikohen si të varfër sipas kriteriumeve të testit zyrtar, të përcaktuara me aktin nënligjor të nxjerrë bashkërisht nga Ministria e Shëndetësisë.

Me miratimin dhe zbatimin e akteve ligjore të lartpërmendura si dhe me miratimin e propozimit të këtij koncept dokumenti, që do t'i paraprijë Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, konsiderojmë se do të plotësohen standardet dhe të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

## **7. Përvoja në shtetet e tjera**

### **Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara**

#### **Përvojat e shteteve**

Fillimisht, si bazë e mirë e trajtimit të kësaj çështjeje është mirë t'i referohemi Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Në nenin 1 thuhet se: "Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre".



Me tutje, në kuptim të kësaj Konvente thuhet se: "Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë".

Një nga parimet themelore mbi të cilat bazohet kjo Konventë është ai i barazisë dhe mos diskriminimit.

Në kuadër të kësaj Konvente, shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim të ndonjë lloji për shkak të aftësisë së kufizuar.

Mirëpo edhe pse shtetet palë duhet të ndërmarrin disa masa për të siguruar gëzimin në mënyrë të barabartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, megjithatë lidhur me rregullimin e statusit dhe të drejtave për personat me aftësi të kufizuara, sa i përket vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve të rajonit ekzistojnë modele të ndryshme, kjo madje varet nga vendet individuale, ku marrin në konsideratë nivelin e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor, etj.

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian duke marrë parasysh kornizën përkatëse të ligjit që i referohet aftësisë së kufizuar, ofrojnë lloje të ndryshme të përfitimeve për njerëzit me aftësi të kufizuara. Këto përfitime kanë për qëllim të promovojnë integrimin ekonomik dhe social të personave me aftësi të kufizuara dhe/ose për të kompensuar disavantazhet e lidhura me dëmtim.

Në disa raste, përfitimet janë pjesë e skemës kombëtare të sigurimeve shoqërore dhe janë në dispozicion vetëm për individët të cilët janë të siguruar sipas skemës përkatëse. Megjithatë, shumë përfitime janë me karakter rishpërndarës dhe nuk kërkojnë një histori të mëparshme të punësimit. Natyra e përfitimeve të tilla gjithashtu ndryshon në masë të madhe. Disa përfitime paguhen në para të gatshme dhe shërbejnë si zëvendësime të të ardhurave të përgjithshme. Ndërsa përfitime të tjera në formë të parave, janë të destinuara për t'u përdorur për qëllime të veçanta, si p.sh. blerje për kujdesin personal ose pajisjet e lidhura me aftësinë e kufizuar. Ekzistojnë edhe përfitime të tjera që përfshijnë qasje të lirë ose të reduktuar të kursit të shërbimeve të ndryshme, të tilla si transporti publik dhe shërbimet e tjera të ofruara nga sektori publik ose privat.

Shtetet anëtare në përgjithësi kanë duar të lira në marrjen e vendimeve për përfitimet të cilat janë në dispozicion për njerëzit me aftësi të kufizuara, si dhe për të përcaktuar se kush ka të drejtë për përfitime të tilla. Pra, legjislacioni i BE-së nuk ka ndikuar mbi lirinë e shteteve anëtare për të përcaktuar shkallën dhe natyrën e aftësisë së kufizuar, e as nuk ka ndikuar në nivelin ose natyrën e përfitimeve të cilat duhet të jenë të siguruara, dhe nuk ka asnjë nivel minimal të



mbrojtjes të përcaktuar nga shtetet anëtare të BE-së për sigurimin e njerëzve me aftësi të kufizuara. Kjo ka çuar në shumëllojshmëri në mesin e shteteve anëtare.

Megjithatë, sot praktikat ndërkombëtare tregojnë se metodologjia e trajtimit të personave me aftësi të kufizuara është qasje inovative dhe gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit dhe promovimit të personave me aftësi të kufizuara me qëllim të integritetit dhe fuqizimit ekonomik të tyre. Duke u nisur nga kjo qasje paraqitet nevoja për një mobilizim më të madh shoqëror, institucional për të ndryshuar konceptin e trajtimit të aftësisë së kufizuar. Këtu duhet të përfshihet edhe formatizimi i modelit të ekipeve që kryejnë vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, në kuptimin e asaj që vlerësimi duhet të përfshijë edhe ekspertizën e fushave të tjera. Në këtë drejtim modeli mjekësor i komisioneve duhet të ndërrohet me modelin social duke shtuar kështu edhe disiplinat te tjera në kuadër të ekipeve vlerësuese.

Sa i përket kornizës ligjore që lidhet me trajtimin e personave me aftësi të kufizuara, vlen të analizohet rasti i **Kroacisë**. Në kuadër të vizitës studimore dhe takimeve me përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Sistemit të Pensioneve, kemi patur rastin të dëgjojmë lidhur me kornizën ligjore për personat me aftësi të kufizuara, por edhe metodologjinë e trajtimit të tyre.

Në fakt çështja e aftësisë së kufizuar është e rregulluar me Ligjin për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. "Person me aftësi të kufizuar, në kuptim të këtij ligji, është një person me pasoja të përhershme të dëmtimeve fizike, shqisore, mendore ose psikologjike ose sëmundje që nuk mund të eliminohen me trajtim ose rehabilitim mjekësor, i cili është përballur me kufizime sociale dhe të tjera, që ndikojnë në aftësinë e punës dhe punësimin ose të mbajë punësimin dhe se nuk ka asnjë mundësi apo një aftësi të reduktuar për të, në kushte të barabarta, të kthehet në tregun e punës dhe për të konkurruar për punësim me persona të tjerë". Në këtë kontekst vlejnë të përmenden procedurat për rehabilitim profesional sipas standardeve dhe udhëzimeve në Qendrën e Rehabilitimit Profesional, planin individual rehabilitues ku në secilin Zyrë Regjionale eksitojnë ekipet multidisiplinare për rehabilitim profesional.

Përveç kësaj, kishte edhe forma inovative të angazhimit dhe punësimin të personave me shkallë të lartë të aftësisë së kufizuar, përmes programeve dhe projekteve të ndryshme, të cilat kishin për qëllim rritjen e hapësirës mjedisore, por edhe ndërgjegjësimin të publikut dhe mediave për aktivitetet e tyre.

Nga ajo që kemi vizituar kemi parë një përkushtim mjaft të madh ndaj zhvillimit dhe promovimit të personave me aftësi të kufizuara me qëllim të integritetit ekonomik të tyre.



Sipas Ligjit për Aftësinë e Kufizuar në **Gjermani**, njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për ndihmë në mënyrë për të shmangur, eliminuar apo përmirësuar aftësinë e kufizuar të tyre. Qëllimi i përgjithshëm është që të tejkalohen, sa më shumë që të jetë e mundur, efektet e aftësisë së kufizuar dhe për të mundësuar të paaftëve për të marrë pjesë në të gjitha fushat e shoqërisë, veçanërisht në tregun e punës dhe në jetën e komunitetit. Ligji gjerman i definon njerëzit me aftësi të kufizuara si persona fizik funksionet e të cilëve, aftësia mendore apo shëndeti psikologjik kanë shumë të ngjarë të devijojnë, për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse dhe pjesëmarrja e të cilëve në jetën shoqërore është dobësuar.

Ajo çfarë e karakterizon Ligjin për Aftësinë e Kufizuar në Republikën Federale të Gjermanisë, është shkalla e aftësisë së kufizuar, ku si prag minimal është shkalla prej 20. Personi me një shkallë prej 50 ose me lartë, konsiderohet si person me aftësi të kufizuara të rënda. Shkalla e aftësisë së kufizuar njihet pas procedurave formale të institucioneve kompetente. Po ashtu, shkalla e aftësisë së kufizuar mund të revokohet ose të përshtatet, nëse përmirësohet statusi i personit me aftësi të kufizuara.

Ekziston edhe një rrjet i gjerë i shërbimeve të tjera të cilat ofrohen për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë punësimin, arsimimin dhe aftësimin si dhe ofrimin e qasjes së barabartë në jetën publike, të cilat kanë për qëllim ngritjen ekonomike dhe sociale të tyre. Atje aplikohet një sistem i kuotimit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, qoftë të punëdhënësit privat apo edhe publik. Të gjithë punëdhënësit të cilët kanë një fuqi punëtore prej 20 apo me shumë, kërkohet që të plotësojnë 5% të vendeve të tyre të punës me personat që kane aftësi të rëndë të kufizuar. Nëse punëdhënësi nuk ka vepruar sipas kuotës, është i obliguar të paguajë një kompensim për secilin vend të paplotësuar.

Pra, ajo që synohet jo vetëm në këto shtete, por në përgjithësi praktikat dhe përvojat e shteteve, bazohen në parimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe përfshirjes së plotë shoqërore të personave me aftësi të kufizuara.

Të njëjtën qasje e hasim edhe te rasti i **Austrisë**, ku përveç aspekteve juridike të rregullimit të çështjes së aftësisë së kufizuar, takojmë një sistem të organizuar të trajtimit të personave me aftësi të kufizuar mjaft mirë. Ekzistojnë institute të specializuara, OJQ, qendra trajnuese dhe rehabilituese, punëtori mbështetëse për punësim të personave me aftësi të kufizuara dhe për sigurimin e kushteve për integrim në shoqëri dhe në tregun e punës të cilat financohen kryesisht nga fondet qeveritare. Një kujdes i madh i kushtohet sigurimit të kushteve për qasje të barabartë në të gjitha objektet, rrugë, mjetet e komunikacionit dhe hapësirat e tjera, përkrahje në kompensim të shkallës së aftësisë së kufizuar, sigurimin e përcjellësve (te kategoria e të verbërve sigurohen nga shteti qenë të trajnuar që



kryejnë këtë detyrë) dhe në raste ekstreme të handikapëve angazhohen edhe ekipe të asistentëve 24 orë me përkujdesje edhe në shtëpi të cilët kompensohen gjithashtu nga fondet qeveritare.

Sa i përket praktikave më të mira të këtyre shteteve të lartpërmendura, konsiderojmë që model me i përafërt do të jetë a i shtetit të Kroacisë

Për dallim nga vendet e tjera, në Kosovë çështja e rregullimit të aftësisë së kufizuar është e fragmentuar, andaj kjo ka shkaktuar që ligjet të mos jenë të harmonizuara rreth përkufizimit të aftësisë së kufizuar dhe shpeshherë janë në kundërtënie në mes vete. Tani me reformën e re të Ministrisë lidhur me rregullimin e çështjes së aftësisë së kufizuar me një ligj më gjithëpërfshirës, mundësohet një adresim më i gjerë i çështjes, aktorëve por edhe i institucioneve që do të përfshihen në të ardhmen në shërbim të kësaj reforme.

Për të arritur këtë duhet të merren parasysh disa rekomandime të cilat janë dhënë edhe në kuadër të asistencës teknike për MPMS-në, përmes instrumentit të TAIEX-it, ku është bërë një analizë gjithëpërfshirëse e praktikave ndërkombëtare të trajtimit të aftësisë së kufizuar. Këto rekomandime janë: ri-përkufizimi i paaftësisë në pajtim me modelin social; Reformimi i vlerësimit të paaftësisë në drejtim të vlerësimit të aftësisë për punë; Plani i rehabilitimit të detyrueshëm për ata që nuk janë të paaftë në shkallë të rëndë; Aspekte të ndryshme për përmirësimin e ligjbërjes (p.sh. zhvillimi i statistikave dhe vlerësimit të nevojave për paravlerësim të ndikimit të legjislacionit).

### **Kapitulli -III:**

#### **8. Synimi**

Përmes këtij dokumenti MPMS-ja do t'i propozojë Qeverisë, përgatitjen e Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili do bazohet në parimet e barazisë dhe mosdiskriminim duke kontribuar në realizimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Ligji do të përcaktojë kategorizimin e personave me aftësi të kufizuara në tri grupe, me dëmtim të funksionimit dhe aftësisë së mbetur për punë.

Në këtë kontekst, synimi kryesor është përkrahja ligjore dhe institucionale për personat me aftësi të kufizuara, me theks të veçantë në reformimin e vlerësimit të paaftësisë, në drejtim të vlerësimit të aftësisë për punë, si dhe aftësive për jetë për fëmijët 0-18 vjeç.



Me miratimin e Ligjit do të krijohen kushtet për përfshirjen e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në shërbime dhe përfitime, sipas kategorizimit dhe llojit të aftësisë së kufizuar që do të trajtohet me Ligjin përkatës.

## 9. Objektivi

Objektivi kryesor i kësaj politike është trajtimi ligjor dhe kategorizimi i Personave me Aftësi të Kufizuara duke përfshirë llojet e aftësi së kufizuar, të cilët nuk janë të përfshirë në legjislacionin në fuqi për mbrojtje social pa dallim moshe, në përputhje me normat dhe praktikrat ndërkombëtare duke mbrojtur dhe promovuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre, me qëllim të ofrimit të standardeve të duhura për jetesë të pavarur dhe mbrojtje sociale.

Qeveria përmes kësaj politike ka për qëllim avancimin e bazës ligjore, ngritjes së pozitës socio-materiale dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në jetën e përditshme, harmonizimin dhe krijimin e një kornize ligjore, duke u bazuar në praktikrat ndërkombëtare dhe eliminimin e dobësive dhe pengesave që ekzistojnë nga ligjet në fuqi që rregullojnë të drejtat në përfitime dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Me aprovimin e këtij koncept dokumenti do t'i jepet mundësi të bëhet kategorizimi në tri (3) grupe dhe do të kategorizohen në bazë të shkallës së dëmtimit trupor.

Pas miratimit të këtij koncept dokumentit, MPMS-ja do iniciojë dhe përgatisë Projektligjin për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili planifikohet që deri në fund të viti 2018, të marrë miratimin nga Qeveria Kosovës dhe të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës më së largu deri në fund të marsit 2019.

## Kapitulli IV: Opsionet

### 10. Opsioni 1: Status Quo *(asnjë ndryshim)*

Korniza aktuale ligjore e fushës së pensioneve, në rast të mos amendamentit, do të vazhdojë të zbatohet me probleme dhe me ankesa të shumta të personave, të cilat janë në rritje çdo ditë. Kjo, për arsye se legjislacioni në fuqi nuk po arrin të realizojë të drejtat minimale për disa kategori të personave me aftësi të kufizuara, gjithashtu ky legjislacion ka edhe mos harmonizimin e kriterëve në përfitime dhe shërbime.

Në rast të mos ndryshimit të kornizës ligjore dhe të mos hartimit të ligjit të ri, do të vazhdojnë të realizohen përfitimet dhe pensionet vetëm për të verbrit,



paraplegjikët dhe tetraplegjikët, kategoritë e luftës, si dhe pensioni i personave me aftësi të përhershme, duke përjashtuar llojet e tjera të aftësi së kufizuar.

E drejta në pension të plotë për shkak të paaftësisë së përhershme, sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ka mundur që një numër i madh i kategorive të ndryshme të PAK-ve, të mos përfitojnë pension nga kjo skemë. Kosova akoma nuk i ka të rregulluara me legjislacion, përfitimet financiare dhe beneficionet për personat me aftësi të kufizuara, varësisht prej shkallës së paaftësisë dhe aftësisë së mbetur për punë. Mungesa e kësaj të drejte te këta persona ka krijuar shumë vështirësi në jetën e përditshme si dhe në integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Gjithashtu, ka hapur rrugët e pakënaqësive të përfaqësuesve të personave me aftësi të kufizuar që të iniciojnë hartimin e ligjeve të veçanta të cilat i rregullojnë të drejtat e tyre në përfitime financiare dhe beneficione. Ligji i parë i veçantë, i cili ka rregulluar vetëm të drejtat në përfitime financiare dhe beneficione, është Ligji Nr. 04/L-092 për të Drejtat e Personave të Verbër dhe Ligji për Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të cilat në njërin anë kanë krijuar beneficione më të avancuara dhe në anën tjetër kanë përjashtuar dhe kanë krijuar disavantazhe në të drejta dhe përfitime, në raport me llojet e tjera të aftësisë së kufizuar. Po ashtu, legjislacioni për invalidët e luftës dhe invalidëve civil të luftës, do zbatohet me mosharmonizim të kriterëve dhe kushteve të përfitimit të pensioneve invalidore të këtyre kategorive.

#### **11. Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese - Amandamenti i legjislacionit në fuqi që trajton çështjen e personave me aftësi të kufizuara**

Ndryshe nga Status Quo-ja, MPMS-ja si propozuese e këtij koncept dokumenti, propozon që të amandamentohet legjislacioni që trajton çështjen e personave me aftësi të kufizuara, të specifikohen dhe eliminohen mangësitë dhe vështirësitë e këtyre ligjeve gjatë zbatimit.

Me rastin e ndryshimit të legjislacionit do të përcaktohen kriteret e qarta për të gjithë përfituesit, gjithashtu do të harmonizohen kushtet dhe kriteret e përfitimi në shërbime sociale, përkrahjen financiare si dhe në vlerësimin e aftësisë së kufizuar, sepse në të gjitha ligjet e veçanta ka mosharmonizim dhe ndryshime të kriterëve.

Ligjet që do ndryshohen, por që nuk kufizohen në to janë:

Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe amandamentimet e tij;

Ligji Nr. 03-L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme;



Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre;

Ligji Nr. 04-L-084 për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës;

Ligji Nr. 03/L-100 për Pensionet e Pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës;

Ligji Nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër;

Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti;

Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Përkundër ndryshimit të ligjeve të lartpërmendura që do të unifikohen edhe kriteret për ato kategori që janë të rregulluara me ligje të veçanta, prapëseprapë nuk do mund të përfshihen të gjitha llojet e tjera të aftësisë së kufizuar që janë jashtë kësaj kornize ligjore aktuale. Për këtë arsye MPMS-ja, konsideron se opsioni më i mirë për fazën e tanishme, është hartimi i Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Miratimi i politikës së rekomanduar për dallim nga politika ekzistuese, është e vetmja alternativë e cila kontribuon në realizim e plotë dhe të duhur të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo politikë nuk do t'i diskriminojë nga të drejtat elementare këtë kategori të shoqërisë dhe do t'i unifikojë të gjithë aktet që trajtojnë personat me aftësi të kufizuara për zbatimin më të lehtë në praktikë.

## **12. Opsioni 3: Opsioni i rekomanduar-Hartimi i Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara**

Opsioni i rekomanduar është hartimi i ligjit që do të garantojë trajtimin e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, duke njohur dhe përfshirë të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar të cilat nuk janë të përfshira në legjislacionin në fuqi për mbrojtje sociale në pajtim me normat dhe praktikën ndërkombëtare. Qëllimi i Ligjit do të jetë mbrojtja dhe promovimi i lirive themelore dhe të drejtat e tyre në mbrojtjen sociale, që ofrohen për secilën lloj të aftësisë së kufizuar të PAK-së.

Me këtë Ligj do të përcaktohet përkufizimi se cili do të jetë person me aftësi të kufizuar, sipas nenit 1 të Konventës së Aftësi së Kufizuar, si në vijim:

"Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërvëprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë".



Gjithashtu, me këtë Ligj personat me aftësi të kufizuara do të kategorizohen në tri (3) grupe, si në vijim:

1. Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të funksionimit në 80% e sipër;
2. Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të funksionimit në 50-79%;
3. Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të funksionimit në mes 30-49%.

Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të funksionimit në 80% e sipër, përveç shërbimeve tjera në bazë të legjislacionit në fuqi që do të specifikohen me ligj, do të jenë përfitues financiar të kujdestarit personal dhe pajisjeve ndihmëse personale.

Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të funksionimit në 50-79% do të marrin të gjitha shërbimet sipas legjislacionit në fuqi. Për rastet e veçanta të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë 50% të përftimit financiar sipas grupit të parë, ligji do t'i përcaktojë specifikisht këto raste të veçanta.

Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të funksionimit në mes 30-49% do të marrin të gjitha shërbimet, sipas legjislacionit në fuqi.

Personat me aftësi të kufizuara me dëmtim të funksionimit nën 30%, në këtë sistem nuk do të klasifikoheshin si të paaftë. Kjo zgjidhje është me qëllim që të mos krijohen ngarkesa të tepruara administrative dhe financiare për implementimin e politikës. Ky grup do të marrë të gjitha shërbimet, sipas legjislacionit në fuqi, sikurse personat e aftë për punë dhe jetë.

Kur përkufizohen kufijtë e saktë të grupeve, këshillohet të konsultohet puna ndërkombëtare e ICF-së në Kosovë për udhëzim në pjesën e shëndetit të vlerësimit të paaftësisë.

Krijimi i organit përkatës, i cili pas vlerësimit nga Komisioni Mediko-Social do të hartojë plan individual për shërbime sociale për personin përfitues. Përpilimi i planit kërkon ekspertizë të ngjashme për vlerësimin e përftimit të shërbimeve sociale për personin d.m.th. ekspertiza mjekësore nuk është e mjaftueshme por së bashku me të duhet të ketë ekspertizë nga arsimit dhe puna, për shembull të përfaqësuar në komision. Fokusi duhet të vihet në nevojat personale të veçanta, aftësitë dhe mundësitë për të hyrë në tregun e punës. Synimi i planit individual është riaftësimi për jetë për fëmijët, si dhe riaftësimi për punë për të rritur.



Nëse kërkohet nga personi (moshë madhore), një plan për riaftësimin personal, ai duhet të bëhet. Po ashtu, edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara të hartohen planprograme dhe module të veçanta që duhet të përcillen.

Secili person (kjo nuk i përket personave me aftësi të kufizuara të lindur dhe diagnozave të pashërueshme) duhet të përcillet, pasi që gjendja e personit mund të ndryshojë me kohë, për shembull, për shkak të statusit të tij shëndetësor, arsimit dhe aftësimin dhe ndryshimet në mjedisin e punës. Mund të jetë e dobishme që nëse personi klasifikohet në ndonjë nga tri grupet, gjendja e tij duhet të rivlerësohet sipas nevojës.

Fuqizimi dhe riemërimi i Komisionit Mediko-Social është i domosdoshëm, i cili do të vendosë fokusin jo vetëm në aspektin mjekësor por gjithashtu edhe në ato social për secilën situatë veç e veç. Komisioni do të vlerësojë edhe shkallën e paaftësisë dhe aftësinë e mbetur për punë për personat e rritur, si dhe gjendjen e tyre sociale dhe mjedisit. Gjithashtu, Komisioni do të vlerësojë edhe gjendjen e fëmijëve. Ky Komision duhet të ketë një ekip kryesor me ekspertizë në mjedisin mjekësor dhe atë social, d.m.th. jo vetëm të mbështeten në ekspertizën mjekësore. Duhet të ekzistojë mundësia për të pasur anëtarë shtesë apo për të ftuar këshilltarë e specialistë të jashtëm kur është nevoja, ose të shfrytëzohen resurset njerëzore profesionale dhe shërbime të SHSKUK-së. Në kuadër të kësaj synohet të arrihet një ekip multidisiplinar mjekësor në nivel të shtetit, për vlerësimin e PAK-së dhe për të paraqitur nevojat e tyre. Pra, profesionistë të lëmive përkatëse nga fusha mjekësore, sociale, edukative dhe e mjedisit, të cilët do të kenë për obligim të referojnë për PAK-të, sipas gjendjes shëndetësore dhe nevojave të tyre. Mënyra e vetme për të arritur rezultate të mira është profesionalizmi i lartë i komisioneve të themeluara dhe kapaciteti i tyre për të kuptuar kontekstin psikologjik dhe social të aplikuesve (përfshirë punën), përveç dëmtimeve të vlerësuara në mënyrë mjekësore.

Është me rëndësi që ligji në mënyrë shumë të qartë do të theksojë organizimin e komisionit, pozicionin e tij në strukturën e administrimit dhe procedurat që ai ndjek në funksionimin e vet. Më detajisht do të rregullohen me akt nënligjor kompetencat e komisionit, përbërja e tij, çështjet e vendosjes, forma e ankesave dhe procedurat standarde për punë e komisionit. Gjithashtu, duhet të ekzistojë një mekanizëm mbikëqyrës, mekanizëm i cili do të përcaktohet me ligj, për të mbikëqyruar funksionimin e këtij komisioni dhe implementimin e legjislacionit relevant.

Reforma synon të mos ketë pasoja negative në statusin e përfituesve nga legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, kjo reformë synon përmirësimin e statusit të të



gjithë personave me aftësi të kufizuara, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira evropiane.

Të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar do të pajisen me librezat unifikuese, me qëllim të përfutimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në institucionet e tjera.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të regjistrohen si punëkërkuar dhe të marrin shërbimet standarde të punësimit dhe aftësimin profesional.

Skemat e ndara të punësimit për persona me aftësi të kufizuara (të cilët nuk mund të kenë qasje të suksesshme në tregun e hapur konkurrues të punës), duhet të zhvillohen apo mbështeten edhe më tej. Ministria, në kuadër të politikave të Agjencisë së Punësimit do të zhvillojë profesione të aftësimin profesional sipas kërkesave të PAK-ve, dhe kërkesave të tregut të punës.

Kur një person me aftësi të kufizuar integrohet në punë, niveli i përfitimit duhet të bjerë më poshtë për të marrë parasysh jetesën nga mjete të tjera, mirëpo duhet të ekzistojë një shkallëzim i përfitimit, në mënyrë që të mbahet një stimulim në drejtim të punësimit. Kjo mund të nënkuptojë për shembull se: nëse të hyrat janë në shumën 50 € beneficioni do të binte vetëm me 40 €.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për PAK-të, do të kemi ulje të numrit të përfituesve në kategorinë e parë të skemës sociale, të cilët përfitojnë sipas paaftësisë së njërit anëtar të familjes që është me aftësi të kufizuara.

Ligji do të hyjë në fuqi nga mesi i viti 2019 dhe pas hyrjes në fuqi të tij, brenda një viti do të rishikohet i gjithë legjislacioni, i cili do të harmonizohet sipas këtij ligji. Nxjerrja e akteve nënligjore, me këtë rast do të bëjë që të ngritën dhe zhvillohen kapacitetet e organeve për zbatimin e ligjit.

Nuk do të ketë kosto financiare shtesë për zbatimin e ligjit, prandaj do të startohet me buxhetin i cili është i ndarë për të gjitha kategoritë që janë përfituese sipas ligjeve të veçanta. Do të aplikohet trajnimi, aftësimi, riaftësimi dhe rehabilitimi për ata të cilët kanë aftësi të mbetura për punë. Ministria brenda strukturës organizative dhe buxhetit të alokuar, do të krijojë organet për hartimin dhe zbatimin e planit për rehabilitim, si dhe vlerësimin e kategorive të reja.

Po ashtu, për zbatimin e këtij ligji në të ardhmen, do të kërkohet mbështetje financiare nga projektet e IPA-s, për aftësim, riaftësim dhe punësim me qëllim të integritit të tyre në tregun e punës, si dhe për krijimin e qendrave punuese dhe punëtorive mbrojtëse për ata të cilët nuk mund të integrohen në tregun e punës



sipas kriterëve të përgjithshme, si dhe për zbatimin e ligjit dhe hartimit të planit individual të rehabilitimit.

#### **Efekt i pozitiv i opsionit të rekomanduar**

Me miratimin e kësaj politike do të arrihet:

- përkufizimi i duhur për PAK-të, sipas konventës së OKB-së për aftësi të kufizuar;
- trajtimi i barabartë i personave me aftësi të kufizuar;
- përfshirja e të gjitha llojeve të aftësisë së kufizuar;
- fuqizimi i organeve për vlerësim dhe hartim të planit individual për rehabilitim;
- kategorizimi i personave me aftësi të kufizuar në tri (3) grupe;
- fuqizimi dhe riemërimi i Komisionit Mediko-Social;
- zbatimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi;
- zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

#### **Efekt i negativ i opsionit të rekomanduar**

Efekt i negativ i këtij propozimi konsiderojmë që do të jetë procesi i vlerësimit të përfituesve të PAK-ve për secilën kategori, si dhe numri i përfituesve që nuk dihet për afërsisht sa persona me aftësi të kufizuara, do të përfshihen në kategorizim, si dhe përfshirja e kategorive të tjera të cilat nuk kanë qenë të përfshira me legjislacionin aktual.

#### **14. Pasojat negative**

Paragjykimi rreth personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi, në shoqërinë kosovare, është ende i sforcuar.

Në përgjithësi, diskriminimi i tyre për shkak të paaftësisë, dominon pothuajse tek të gjithë PAK-të. Diskriminimi dhe mospërfshirja e tyre në jetën shoqërore dhe mosintegrimi në shoqëri ende ekziston. Gjithashtu, edhe për një numër të konsiderueshëm të atyre që janë pjesë e shërbimeve dhe përfitimeve, ka moszbatim dhe dallime në standarde. Mosinformimi i tyre për të drejtat themelore të njeriut, përkatësisht, mospërfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse qysh në fazat e hershme të politikbërjes, përkeqëson edhe më shumë gjendjen statusore të tyre. Kështu që do të përkeqësonin imazhin e tyre, qasjen ndaj vetvetes, familjes shtetit dhe mbarë shoqërisë.



## **Kapitulli VIII: Krahasimi i opsioneve**

Pasojat e opsionit të parë: Mos ndryshimi i situatës aktuale, bazuar në përfitimet pozitive dhe negative dhe vlerësimi i përgjithshëm për pasojat, konsiderohet të jetë negativ. Ky vlerësim, është për arsye se personat me aftësi të kufizuara, do të vazhdojnë të marrin beneficione dhe pension të aftësisë së kufizuar, sipas ligjeve të veçanta duke paraparë disavantazhe dhe diskriminim në mes të këtyre kategorive dhe mospërfshirjen e kategorive tjera.

Pasojat e opsionit të dytë: Ndryshimi i një mori ligjesh në fuqi që trajtojnë kompensimet dhe pensionet për personat me aftësi të kufizuara, për një kohë të shkurtër nuk është e mundur të realizohet. Ky vlerësim, do të ishte me ndikim negativ në aspektin kohor, organizativ dhe më kryesore në aspektin financiar, për një periudhë afatmesme.

Pasojat e opsionit të tretë: **Hartimi i Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.**

Në bazë të vlerësimit të përgjithshëm, nëse krahasojmë pasojat dhe ndikimin e të tri opsioneve, konsiderojmë që opsioni i tretë është më i zbatueshëm, më i menaxhueshëm, si dhe më i përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës, duke pasur parasysh të gjitha aspektet e mundshme, si: financiare, organizative, gjithëpërfshirëse dhe administrative. Kjo për arsye se: do të ndalohej diskriminimi i PAK-ve, do të përfshihen të gjithë personat me aftësi të kufizuara, do të harmonizohen kriteret e përfitimit, do të fuqizohet Komisioni Mediko-Social, si dhe do të përcaktohet institucioni për hartimin e planit individual të rehabilitimit.

Të gjitha këto vlerësime krahasuar me opsionet e tjera, MPMS-ja i planifikon përmes hartimin e Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

### **15. Efekti shpërndarës**

Efekti shpërndarës i kësaj politike, do të ketë shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Të gjitha ndryshimet e tilla ligjore, do të kenë efekt të drejtpërdrejtë te personat me aftësi të kufizuara pa dallim gjinie.

Përcaktimi dhe realizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në trajtim të barabartë dhe pa diskriminim, konsiderohet çështje e nivelit nacional. Shteti i Kosovës ka përgjegjësi për ofrimin e sigurimit të mbrojtjes sociale të të gjitha kategorive në nevojë.



## 16. Kostoja

Kostoja e përgjithshme e opsionit të rekomanduar është paraqitur në Formularin e Vlerësimit të Ndikimit Financiar, e cila është pjesë e këtij dokumenti.

Me aprovimin e këtij Koncept dokumenti do të hartohet Ligji për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësitë të Kufizuara, përmes të cilët do të përcaktohet shkalla e paaftësisë dhe aftësia e mbetur për punë për personat e rritur, si dhe gjendja e tyre sociale dhe e mjedisit. Gjithashtu, Komisioni do të vlerësojë edhe gjendjen e fëmijëve, sipas konventave ndërkombëtare për aftësinë e kufizuar. Të gjithë përfituesit aktual do të trajtohen dhe do të jenë pjesë e vlerësimit dhe përcaktimit të shkallës së paaftësisë dhe aftësisë së mbetur për punë.

Me aprovimin e këtij Koncept dokumenti nuk do të krijohen implikime shtesë buxhetore, pasi që do të mbulohen nga buxheti aktual për vitet vijuese i planifikuar në kuadër të MPMS-së, për mbulimin e pagave dhe kompensimet e seancave për Komisionet Mjekësore. Të gjitha përfitimet dhe shërbimet që do t'i gëzojnë personat me aftësi të kufizuara pas procesit të vlerësimit dhe hartimit të planit individual për rehabilitim, do të jenë subjekt i trajtimit të ligjeve të tjera, duke mos tejkaluar kufirin buxhetor dhe buxhetin e alokuar për skemat e pagesave të pensioneve, përfitimeve dhe shërbimeve të cilat janë të planifikuara në kuadër të buxhetit për vitin 2019 dhe KASH 2019-2021.

## Kapitulli VII: Konsultimi

Prej vitit 2016 në MPMS ka pas iniciativa për hartimin e këtij koncept dokumenti. Në kuadër të veprimeve dhe iniciativave, kemi kërkuar asistencë nga TAIEX-i me dy ekspertë të fushës, për idenë e hartimit të draftit të parë të këtij koncept dokumenti.

Gjithashtu, është bërë konsultimi i paraparë me të gjithë aktorët relevantë, përfshirë edhe OJQ-të që merren me trajtimin e PAK-ve, për idenë fillestare të këtij koncept dokumenti.

Kështu që, MPMS-ja ka përfshirë në planin e punës së Qeverisë, hartimin e koncept dokumentit në fjalë. Prej vitin 2017 e këndeje është bërë një konsultim i gjerë në lidhje me diskutimin dhe përmbajtjen e këtij koncept dokumenti, ku MPMS-ja ka krijuar grupin e punës dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet sipas legjislacionit në fuqi.

Përveç kësaj, Shoqata "Down Syndrome Kosova" në kuadër të projektit "Fuqizimi i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara drejt zgjerimit të pjesëmarrjes në jetën sociale", përkrahur nga programi e 4-ATR dhe mbështetur



nga USAID-i në bashkëpunimin me MPMS-në, ka ndihmuar dhe përkrahur në hartimin dhe finalizimin e koncept dokumentit në fjalë.

Si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, janë organizuar punëtoritë për hartimin e koncept dokumentit të Projektligjit gjithëpërfshirës.

Në punëtori kanë qenë pjesëmarrës të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, si: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra Ligjore e ZKM-së, Zyra e Avokatit të Popullit, OSBE-ja, ekspertët e angazhuar në kuadër të projektit, si dhe të gjitha shoqatat që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në kuadër të Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar. Janë mbajtur gjithsej pesë (5) punëtori me grupin e gjerë, si dhe 4 punëtori me grupin e ngushtë. Gjithashtu, për këtë koncept dokument, kemi pas edhe asistencë teknikë nga TAIEX-i, ku është përgatitur edhe drafti fillestar dhe konsultimet me aktorët relevantë.

Procesi konsultimeve publike ka filluar më datën 07.05.2018 dhe ka mbaruar më datën 01.06.2018. Gjatë këtij procesi, MPMS-ja si organ propozues, i ka dërguar për konsultime paraprake edhe publike, këtyre institucioneve:

Sekretariatit Koordinues të Qeverisë; Zyrës për Planifikim Strategjik të ZKM-së; Zyrës Ligjore të ZKM-së; Agjencinë për Barazi Gjinore të ZKM-së; Ministrisë së Financave; Ministrisë së Integritimit Evropian; Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Ministrisë së Pushtetit Lokal; Ministrisë së Shëndetësisë; Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministrisë së Punëve të Brendshme; Ministrisë së Administratës Publike; Sekretariatit të Këshillit Konsultativ për Komunitete; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; Avokatit të Popullit; OSBE-së; HENDIKOS-it; Forumit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga këto institucione, kemi pranuar komente nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë së ZKM-së që drafti i koncept dokumentit është hartuar në përputhje me udhëzuesin për hartimin e koncept dokumentit, se problemi është identifikuar, si dhe ka informacione të mjaftueshme për të shpjeguar qëllimin e përgjithshëm të politikës së propozuar. SKQ-ja, ka rekomanduar disa modifikime të përshkrimit dhe përcaktimit të problemit kryesor dhe të opsionit, gjë që është bërë pas procesit të konsultimeve. Nga këto konsultime kemi pranuar komente edhe nga shoqata e personave me aftësi të kufizuara "Handikos". Gjithashtu, koncept dokumentin e kemi publikuar edhe në platformë online të konsultimeve.

Të gjitha komentet e pranuar janë shqyrtuar nga ekipi përgjegjës për hartimin e këtij koncept dokumenti.



## **Kapitulli XIX: Rekomandimi**

Rekomandimi i MPMS-së për Qeverinë e Kosovës, si organ propozues i këtij koncept dokumenti, është miratimi i opsionit të tretë të rekomanduar. Përmes opsionit të rekomanduar do të hartohet Ligji për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Me miratimin e këtij opsioni, MPMS-ja planifikon hartimin e Ligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, të cilin do ta përfshijë në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2018, ndërsa do ta hartojë dhe procedojë në Qeverinë e Kosovës për miratim, më së largu deri në fund të vitit 2018.

## **Kapitulli X: Komunikimi**

Mënyra e komunikimit me aktorët, përkatësisht, me institucionet dhe grupet e interesit, ka qenë e hapur dhe transparente. Politika e propozuar ka qenë fillimisht e publikuar nga vet Ministri i MPMS-së, gjatë rishikimit të kornizës ligjore në fuqi. Gjithashtu, ka qenë kërkesë edhe e të gjitha OJQ-ve që trajtojnë personat me aftësi të kufizuara gjatë vitit 2016, Komisioneve Parametrale, Avokatit të Popullit dhe Komisionit Evropian. Ministri i MPMS-së, është shprehur disa herë për opsionin e rekomanduar të këtij koncept dokumenti. Me miratimin e këtij koncept dokumenti, MPMS-ja do të ftojë të gjithë aktorët për të diskutuar dhe marrë pjesë aktive në hartimin e Projektligjit për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.